



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

VENDIM

Nr. 92/2018

**PËR SHQYRTIMIN ME PROCEDURË TË PËRSHPEJTUAR TË PROJEKTLIGJIT
“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9831, DATË 12.11.2007,
“PËR DËMSHPËRBLIMIN E ISH-TË DËNUARVE POLITIKË TË REGJIMIT
KOMUNIST””, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, pika 1, dhe 83, pika 2, të Kushtetutës, si dhe të neneve 28 dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Të shqyrtojë me procedurë të përshpejtuar projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9831, datë 12.11.2007, “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist””, të ndryshuar.

II. Shqyrtimi në Komisionin përgjegjës për Ekonominë dhe Financat të bëhet në datat 10-11 shtator 2018.

III. Amendamentet të dorëzohen në komisionin përgjegjës brenda datës 7 shtator 2018.

IV. Shqyrtimi në seancë plenare të bëhet në datën 13.9.2018.

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI

Miratuar në datën 3.9.2018